



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 14 dhe 17, shkronja (c) dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e në mbështetje të nenit 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 29.03.2019, miratoi këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e interes të përgjithshëm

Neni 1

Me këtë vendim shpallen interes i përgjithshëm publikë objekte e cekura më poshtë;

1.1 Objekti me sipërfaqe të përgjithshëm 220m² i cili menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) e që është i ndërtuar në pjesën e parcelës kadastrale me **P-72116029-02390-2** sipas certifikatës së pronës Nr.842/2019 e datës 06.03.2019, zona kadastrale Mushtisht, vendi i quajtur "Fshat" e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik është **"Ndërtimi i parkut"** që do të shërbejë për amfiteatrin e fshatit Mushtisht.

1.2 Objekti me sipërfaqe të përgjithshëm 678m² i cili menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) e që është i ndërtuar në pjesën e parcelës kadastrale me **P-72116045-02270-0** sipas certifikatës së pronës Nr.2270/2019 e datës 07.03.2019, zona kadastrale Studençan, vendi i quajtur "Rashica" e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik është shfrytëzimi i objektit për **"Çerdhe të fëmijeve dhe këndi për të moshuarit"** për fshatin Studençan.

Neni 2

Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 3

Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në librin kadastral, do të jetë Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadaster në Komunën e Suharekës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadaster në Komunën e Suharkës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr. 01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-21662
Me datë 29.03.2019



Kryesuesi Kuvendit

Bexhet KUÇI